


# Sistem Modular SCBA për aplikimet e shërbimit emergjent

*Zgjidhje optimale për çdo shërbim zjarrfikës*

MSA
The Safety Company

# Sistemi Modular SCBA

Në mbarë botën, personeli i shërbimit zjarrfikës mbështetet në sistemet SCBA të MSA-së për mbrojtje të frymëmarrjes. Besimi i tyre dhe përkushtimi ynë i vazhdueshëm për të krijuar pajisje të sofistikuara për mbrojtje personale të standardeve më të larta, e ka bërë MSA-në furnizues kryesor të sistemeve SCBA në mbarë botën. Sistemet tuaja SCBA gjithashtu mund të kombinohen me helmeta MSA kundër zjarrit, kostume për mbrojtje kimike, sisteme monitorimi që punojnë së bashku për siguri dhe efikasitet.

**E testuar ndër vite, e aprovuar në aplikim**

**P**ërdorimi i SCBA në shërbime emergjente është i gjerë dhe klientet tanë kërkojnë shkathtësi në pajisjet e tyre. Kjo është arsyeja pse sistemet e aparatit të frymëmarrjes MSA janë krejtësisht të personalizuara për të përmbushur çdo aplikim dhe çdo buxhet. Me konfiguruesin tonë të lehtë për tu përdorur, të gatshme në CD ose online, ju mund të ndërtoni sistemin tuaj të SCBA pikërisht ashtu siç ju nevojitet. Bazuar në përvojën tonë shumëvjeçare, ne gjithashtu ofrojmë tri modele të SCBA (AirGo pro, AirMaXX dhe eXXtreme)- sisteme të konfiguruara për aplikimet më të zakonshme.

**Teknologji që ka kuptim**

Gjatë viteve të fundit MSA ka krijuar një revolucion me serinë *alpha* të pajisjeve të sofistikuara të sigurisë.

Të gjitha komponentet e *alpha* përqëndrohen në rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe aftësive duke ruajtur thjeshtësinë e dizajnit dhe lehtësinë e përdorimit.

**E ndërtuar për të zgjatur**

Të gjitha komponentet premium të MSA-së janë të dizajnuara për jetë të gjatë dhe mirëmbajtje të ulët. Ato ofrojnë vlera të jashtëzakonshme përmes kostos totale të reduktuar të pronësisë. Komponentet e SCBA MSA janë të miratuara sipas EN 137:2006 për të përmbushur kërkesat e vështira të klasës 2 për tu përballur me temperaturat e larta, flakët dhe trajtime të ashpra. **T**ë gjitha komponentet janë gjithashtu të sigurta në thelb dhe të aprovuara me ATEX për mjediset e zones 0.

**Lehtë për tu përdorur**

Sistemi SCBA i MSA-së, si të gjitha pajisjet tona, është gjithmonë i dizajnuar për përdorim të lehtë në kushte sfiduese të punës. Për shembull, të gjitha rregullimet në SCBA-të tona mund të bëhen me doreza pune.

**E përshtatshme për servisim**

Me objekte në 140 shtete dhe trajnim të vazhdueshëm të personelit, produktet tona mbështeten me servis shumë të shpejtë nga MSA



# Pajisja univerzale
## AirGo pro

Nëse jeni duke kërkuar një transportues të rëndë për një gamë të gjerë zjarrfikësish, operacione emergjente ose të shpëtimit, AirGo është i gatshëm për përdorim. Besueshmëria, fleksibiliteti dhe vlera e madhe e saj e bëjnë një zgjedhje të kërkuar për brigadat profesionale, vullnetare, ushtarake dhe industriale.

Pesha shpërndahet në mënyrë të barabartë dhe mbahet pranë trupit tuaj për të zvogëluar stresin dhe lodhjen.

Sistemi pneumatik *alpha* SingleLine integron sinjalin paralajmërues, lidhjen e dytë dhe manometrin në supe.

Rrjeti Personal *alpha* ofron monitorim të zgjeruar elektronik dhe telemetrik si dhe mundësi komunikimi. Personeli i shërbimit zjarrfikës anembanë botës që kërkon cilësi të lartë, besueshmëri dhe rehati të plotë përdorin AirGo pro për mbrojtje të frymëmarrjes.

Për porosi të shpejtë: 10086571






# Për ata që kërkojnë më të mirën

## AirMaXX

Për përdorim të shpeshtë të SCBA-së, rehatia maksimale e përdoruesve reflektohet me përformancë të lartë dhe shëndet të mirë.

SCBA AirMaXX kombinon tiparet ergonomike premium me teknologji të përparuar për të ofruar përvojen më të mirë në qëndrueshmërinë e SCBA-së e cila është në dispozicion sot.

E dizajnuar ergonomikisht dhe e balancuar në mënyrë optimale shpinorja AirMaXX është e rregulluar që të përshtatet për të gjitha madhësitë e trupit. Kjo funksionon së bashku me jastëkët e krahut të formës S dhe rripin e lakuar të belit për të shpërndarë peshën në mënyrë të barabartë, duke rritur lirinë e lëvizjes. Stresi dhe lodhja zvogëlohen ndërsa kryeni punën pa kufizime. AirMaXX qëndron edhe nëse jeni kthyer me kokë poshtë.

Sistemi pneumatik *alpha* SingleLine integron lehtë sinjalin paralajmërues, lidhjen e dytë dhe manometrin në supe.

Rrjeti Personal *alpha* ofron monitorim të zgjeruar elektronik dhe telemetrik si dhe mundësi komunikimi.

Nëse jeni duke e përdorur SCBA shpesh, për periudha të gjata kohore ose thjeshtë kërkoni më të mirën, AirMaXX është zgjedhja e duhur.

Për porosi të shpejtë: 10060803




## AirMaXX

Shpinorja AirMaXX premium mund të rregullohet në tri gjatësi të ndryshme në mënyrë që të balancohet mirë në bel pa e humbur kontrollin. Manometri është gjithnjë në pozicionin ideal në gjoks. Konstruksioni i fortë i patentuar mund të rregullohet edhe me doreza. Pajisja vjen standard me një shirit të gjatë për dy cilindra, mbajtëse për cilinder gome me mbërthyese lëvizëse të patentuar, ndarës dhe amortizatorë. Rripi rrotulues i belit i patentuar është një tipar tjetër i sofistikuar i kësaj shipinore të kualitetit të lartë.

**Si një alternativë për SCBA-në ju mund të konfiguroni sistemin tuaj individual SCBA duke zgjedhur komponentët sipas nevojës. Këto faqe ju ofrojnë një përmbledhje**

# RRIPAT



## **pro** (Të butë)

Shirita për supe shumë të butë dhe rripi i belit shpërndan ergonomikisht peshën e SCBA dhe është i rehatshëm. Lidhëset shumë të sigurta veshen dhe zhveshen shpejtë. Shiriti i belit përshtatet thjeshtë duke e tërhequr përpara. Materiali Nomex ofron qëndrueshmëri të lartë.



## **eXXtreme** (Të fortë)

Këta rripa ofrojnë të njejtën rehati si rripat MaXX dhe janë të përshtatshëm për përdorim të shpeshtë në situata ekstreme të trajnimit, si ushtrimet për ndaljen e zjarrit. Përbëhet prej fibrave aramid zjarr-duruese dhe linja mbrohen nga tunelet izolues PriOx. Shtresa e fundit lejon pastrim të lehtë. Mbërthyese çeliku e qëndrueshme.

Të dyja shpinoret e MSA përmbajnë materiale poliamide të përforcuara me fibra qelqi rezistente ndaj nxehtësisë. Dizajni siguron tuba të përshtatshëm për veshje të lehtë dhe përdorim të sigurtë. Një transponder i integruar siguron menagjim të informatave mbi SCBA.

## AirGo

Shpinorja e fortë AirGo ofron fleksibilitet të lartë. Dizajni antropomorfik është projektuar për të balancuar peshën përgjatë strukturës skeletore të trupit në mënyrë që të evitohen pikat e stresit gjatë veshjes për kohë të gjatë. Tubat janë të orientuar për veshje të lehtë dhe operacione pa pengesa. Shpinorja AirGo vjen me opcione të ndryshme



**Amortizatorë për qëndrueshmëri më të lartë**
- Mbrojtje e lartë për sistemin SCBA



**Shirit i gjatë, ndarëse & mbajtëse gome për 2 cilindra.**
- Siguron ndarjen dhe përshtatjen e dy cilindrave
- Për një ose dy cilindra prej 4 deri në 6.9 litra
- Ndarësja palohet nëse nuk nevojitet
- Mbërthyese e shpejtë e patentuar për mbërthim të shpejtë dhe të sigurtë.



**Opcionet AirGo**
**Rripi rrotullues i belit për fleksibilitet të lartë:**
- Është majftueshëm elastik për të lejuar liri gjatë lëvizjes
- Rrotullimi është i kufizuar dhe ndalesa e butë rritë ndjenjën e sigurisë

MSA PATENT



Të gjithë rripat e MSA përdorin materiale rrezistente ndaj zjarrit dhe mund të pastrohen në makinë larëse. Gjatësitë e shiritave të supeve dhe të belit mund të ndryshohen. Mbërthyeset plastike parandalojnë lëndimin e gishtërinjëve.

## MaXX (premium)

Rripat tanë të performancës së lartë janë të rehatshëm dhe mbështesin shëndetin afatgjatë duke ulur njëkohësisht stresin dhe lodhjen. Dizajni i rripave të supeve parandalon rrëshqitjen. Rripi i belit përshtatet lehtësisht duke e tërhequr përpara.
Lidhëse shumë të sigurta lejojnë veshjen e shpejtë



Shiritat e supeve fomës-S sigurojnë lëvizje pa pengesa



Konstruktimi Sandwich i mburojës së kualitetit të lartë Protex dhe materiali zbutës sintetik ofron rehati afatgjatë dhe durueshmëri të lartë



Rripi rrotullues i belit balancon peshën midis strukturës së sipërme dhe të poshtme. Ndalesa e butë dhe rrotullimi i kufizuar rrisin ndjenjën e sigurisë.

# PNEUMATIKA

## *alpha* SingleLine

Në shumicën e rasteve pyetja e parë që bëhet për SCBA-në alpha SingleLine është “Ku gjinden tubat?”. Sistemi i patentuar përmbledhë valvuolën thithëse, lidhjen dytësore, manometrin dhe linjën e sinjalit në një tub të vetëm. Inxhinjerët e MSA kanë përdorur një kombinim të shkencave të avancuara të materialeve, dizajn të menqur dhe teknologji të re për të revolucionuar pneumatikën e SCBA.




MSA PATENT



### Tub-në-tub

Në zemrën e alpha SingleLine është teknologjia e patentuar tub-në-tub. Linjat e shtypjes së lartë kalojnë përbrenda linjave të shtypjes së mesme të cilat gjithashtu sillen si mbulesë mbrojtëse.

**Avantazhet e pneumatikës SingleLine**

- Qëndrueshmëri e lartë
- Më e lehtë
- Më pak mirëmbajtje
- Kosto më e ulët e pronësisë



# ELEKTRONIKA

komponentët elektronik të MSA janë të aprovuara me ATEX T4

## *alpha*MITTER

- Dërgon të dhëna rreth shtypjes së ajrit te alphaSCOUT çdo sekond
- E integruar në shpinore
- Shkëmbimi i sinjaleve Wireless USB krijon një rrjet të definuar rreth përdoruesit
- Më shumë detaje rreth Rrjetit Personal alpha në faqen 11



MSA PATENT

## ICU

Sistem i alarmeve opsional për pneumatikën klasike me manometer mekanik dhe digjital, gjatë gjithë kohës monitoron dhe tregon:

- Shtypjen
- Lëvizjen
- Tempreaturën
- Kohën e mbetur të shërbimit
- Statusin e baterisë

MSA PATENT

Të dhëna për deri në 30 incidente mund të lexohen dhe të procesoen nga programet e MSA. Një çelës për ngritje të përgjegjësisë dhe lehtësimin e mirëmbajtjes është i gatshëm.



Zvogëluesi i shtypjes i fazes së parë nga MSA, është më moderni i gatshëm. Është i durueshëm dhe ka një ndërtim të thjeshtë dhe të lehtë që kërkon mirëmbajtje minimale.

Opcionet e SingleLine:



Me përshtatësin QuickFill, cilindrat mund të mbushen ndërkohë që pajisja është e veshur. Mbushja e cilindrave kryhet për 45 sekonda.



Lidhja e tretë e shtypjes mesatare me mbërthyese për shpëtim ose për qarkullim të ajrit. Montohet në rripin e belit.



Përshtatës i ndërrimit të cilindrave i shpejtë alphaCLICK.
Për më shumë detaje ju lutem shikoni faqe

## Klasikja

Sistemi pneumatik klasik i MSA përdorë linja individuale për secilin funksion. një linjë e shtypjes mesatare që furnizon valvuolën thithëse, një linjë e shtypjes së lartë me manometer janë standarde. Linja e vetme, lidhja e dytë dhe njësia e kontrollit e integruar (ICU) janë opcionale

Opcionet klasike:



S: jep sinjalin e shtypjes së ulët të linjës së vetme afër veshit



Z: Lidhja e dytë për misione shpëtimi



Përshtatës i ndërrimit të cilindrave i shpejtë alphaCLICK.
Për më shumë detaje ju lutem shikoni faqen 10.

# Kur 100% nuk janë mjaftueshëm

## Përdorni: eXXtreme

Ekspozimi i shpeshtë me flakë dhe nxehtësi nga trajtimi i shpeshë dhe i vështirë zakonisht i dëmton shumë pajisjet. Pajisja eXXtreme përdorë materiale të veçanta për të zvogëluar mirëmbajtjen dhe koston e përdorimit të komponentëve kritik të cilët mund të nevojitet që të zëvendësohen shpesh në aplikime ekstreme të tilla. Rripat përbëhen nga fibra aramid ekstra të forte dhe zjarr-duruese ("PreOx"). Ka një shtresë që parandalon hyrjen e ndyrësirave dhe rrjedhimisht lehtëson pastrimin. Tubi i ajrit është i mbrojtur nga zjarri dhe nxehtësia nëpërmjet tuneleve izoluese në pjesën e krahëve. Për të lejuar ndërrimin e shpeshtë të cilindrave, siq nevoitet gjatë trajnimeve, pajisja eXXtreme është e pajisur me alphaCLICK (për më shumë detaje shikoni faqen 10). të gjitha vetitë tjera si shpinorja AirMaXX dhe komponentët *alpha* janë identike me pajisjen AirMaXX.

Trajnerët dhe të tjerët të cilët punojnë në rrethana të shpeshta me nxehtësi të lartë dhe zjarr zgjedhin eXXtreme.

Për porositje të shpejtë: 10069671



# Ndërruese e shpejtë e cilindrave

## alphaCLICK

Me mbërthyesen revolucionare dhe të patentuar alphaCLICK, juve nuk ju nevoiten thurrjet e tepërta, thjesh mbërtheni cilindrin tuaj me zvogëluesen e shtypjes së SCBA dhe jeni gati.
alphaCLICK ju lejon që të ndërroni cilindrat deri në 10 herë më shpejtë se sa thurrjet e mëherëshme dhe gjithashtu përmirëson sigurinë




### Siguri dhe efikasitet me një klikim

Sisteme të shumëta janë të vendosura për të siguruar mbrojtje të plotë dhe të besueshme. Në fakt, alphaCLICK ofron disa avantazhe sigurie më shumë se sa lidhja me thurrje.
Së pari, përshtatësi alphaCLICK mund të zbërthehet vetëm kur nuk ka shtypje, edhe atëherë kërkon një proces dy-hapësh të zbërthimit. Një unazë lëshimi me sustë duhet që fillimisht të kthehet 20 shkallë, pastaj cilindri është i lire të zbërthehet thejsht duke e shtyrë unazën mbrapa.

### Vetitë e dukshme

- Ju lejon që të ndërroni cilindrin 10 herë më shpejtë se sa versionet me thurrje
- Përshtatet me të gjitha valvuolat të cilindrave standard me thurrje 200 ose 300 bar.
- Lëshim i sigurisë: një sekuencë shkëputjeje me dy hapa
- Ndalues i rrjedhës shmang rrjedhën e ajrit të pakontrolluar
- Përshtatet në të gjitha shpinoret AirGo, AirMaXX dhe BD 96 SCBA.

Një opsion siguri shumë i vlefshëm i alphaCLICK është ndaluesi i rrjedhës i cili automatikisht vepron kur cilindri nuk është i lidhur. Nëse valvuola e cilindrit aksidentalisht kthehet atëherë ndaluesi i rrjedhë nuk e lejon cilindrin që të dale jashtë kontrollit.
alphaCLICK ka një mbrojtje kundër ndotjes të integruar, e cila e mban ajrin e pastër dhe siguron funksionim të mirë.

### Ekonomia

Shumë pajisje përmirësuese janë të gatshme për të përshtatur zvogëlueset ekzistuese të shtypjes MSA ose për pneumatikën e plotë SingleLine.

### Përmirësimet

Pjesa më e mirë e alphaCLICK është që përshtatet me të gjithë cilindrat e thurrur standard 200 ose 300 bar (EN 144-2), që siguron vlerën e pajisjes. alpha është gjithmonë e para kur vjen për efikasitet të kostos.

### Panelet e mbushjes

Panelet mbushëse ekzistuese të MSA mund të përshtaten për alphaCLICK. Setet për 200 ose 300 bar përmbajnë lidhje të dyfishta, mbyllëse të sheshtë vulosje dhe shtresa të brendshme. Panelet e plota të mbushjes për kompresorë me lidhje alphaCLICK të versioneve të ndryshme janë të gatshme sipas kërkesës.

### Manometri testues

Manometri testues alphaCLICK bën kontrollimin e shtypjes së cilindrave një punë sekondash.





Përshtatësi i cilindrave i shpejtë alphaCLICK është shumë me vlerë në panelin e mbushjes në punëtori.

# Monitorimi

## Rrjeti Personal *alpha*

Rrjeti Personal *alpha* është një set i komponentëve komunikues dhe matës. Ato mund të kombinohen në shumë lloje konfigurimesh për të krijuar mundësi të ndryshme telemetrike, të monitorimit dhe të alarmeve.

Në qendër të këtijë sistemi është një pajisje e monitorimit personal dhe të sinjalizimit, wireless, që quhet alphaSCOUT. Pasi një alphaSCOUT e vetme nuk lidhet me një SCBA specifike, atëherë numri i tyre i nevojshëm nga ndonjë organizatë mund të jetë deri në 75% më i vogël. alphaSCOUT merr informata mbi shtypje e ajrit në SCBA nga transmetuesi alphaMITTER — që gjindet në shpinoren e SCBA — për çdo second. alphaSCOUT pastaj kalkulon kohën e mbetur të shërbimit. alphaSCOUT mund të personalizohet nga etiketa identifikuese alphaTAG, me p.sh. emrin, skuadrën ose automjetin. Funksione të tjera të veçanta mund të aktivizohen nga alphaTAG, funksione të: Shoqërimit, Përsëritjes, Sinjalizimit dhe Ndaljes (Gjumit).



Maska Ultra Elite me alphaHUD të integruar



alphaBASE standard plus PC



TABLET PC xplore me alphaBASE, punon me bateri



alphaMITTER transmetues me shtrirje të shkurtër

**Mbikqyrje me Radio SCBA**

alphaSCOUT mund të përforcohet me mundësi telemetrike në mënyrë që të dërgohen dhe pranohen sinjale me shtrirje të gjerë. kjo lejon që të dhënat personale të mbikqyren gjatë tërë kohës nga komandat e stacionit bazë. Programi i mbikqyrjes i MSA punon automatikisht pa intervenime të operatorëve. Të dhëna të plota të rastit gjithashtu ruhen dhe analizohen automatikisht. një mesazh evakuimi mund ti dërgohet skuadrave incidente ose ekipës së tërë.

**Stacioni bazë**

Për stacionin bazë ju mund të zgjidhni mes dy pranuesëve. alphaBASE është pranuesi standard i cili punon në kombinim me cilindo PC. Një version me bateri i alphaBASE mund të vendoset në TABLETIN PC xplore dhe të formojë një bazë të plotë mobile pë mbikqyrje të SCBA.

**HUD (Heads-Up Display)**

alphaHUD ofron mbikqyrje shtesë ose alternative pa duar. Informacioni ofrohet nga një sistem i dritave LED në periferinë e ulët të shikimit brenda maskës.

Varësisht prej konfigurimit, alphaHUD mund të japë sinjale rreth shtypjes, gazrave dhe për evakuim.

Për detaje të mëtutjeshme, ju lutem kërkoni për broshurën e Rrjetit Personal alpha të MSA

# Valvuolat Thithëse

## AutoMaXX

Reagim sensitiv sipas frymëmarrjes së përdoruesit ndërkohë që përballon kushtet më të vështira: AutoMaXX definon valvuolën thithëse moderne. Plus, qendra e valvuolës ka shumë pak nevojë për mirëmbajtje gjë që e ulë koston e përdorimit. Shtëpiza unike e AutoMaXX siguron që ajo nuk mund të përdridhet dhe gjithashtu ofron mbrojtje më të lartë nga goditjet.

### Veshje e lehtë

Mundësia e rrotullimit të shtëpizës dhe linjës me shtypje mesatare të AutoMaXX ofrojnë liri maksimale të lëvizjes dhe rehatisë. ju mundeni që thjeshtë ta ktheni lidhjen e tubave deri sa ajo nuk ju pengon më. Valvuola thithëse drejtohet nëpërmjet mushkërive dhe aktivizohet shumë lehtë me frymëmarrjen e parë dhe gjithashtu operon pa zhurmë. Versioni AS automatikisht zhduk shtypjen positive kur largohet nga maska.

### Kujdes i lehtë

Shtresa mbrojtëse e AutoMaXX mund të hiqet lehtësisht dhe të lejojë inspektimin e diafragmës. Montimi i valvuolës nuk kërkon lubrifikim të shpeshtë. Nuk ka nevojë për mirëmbajtje të mëtutjeshme përveq ndonjë kontrolli të përgjithshëm.

### Opsionet

AutoMaXX ofrohet në këto versione:

**N:** shtypje normal me thurrje të thërthortë standarde,
**AE:** shtypje pozitive me thurrje M 45 x 3,
**AS:** shtypje pozitive me lidhje të tapës MaXX,
**AS-C;** kombinim i AE dhe AS.

Për më tepër e keni zgjedhje për opsionet e mëposhtme:

**G:** linjë e shtypjes mesatare prej gome për aplikime industriale,
**B:** valvuola e kalimit ofron një rrjedhë ajri konstante dhe të përshtatshme,
**Short:** linjë e shtypjes mesatare më e shkurtër (rekomandohet në kombinim me teknologjinë SingleLine).



**AutoMaXX-N**



**AutoMaXX-AE**



**AutoMaXX-AS**



**AutoMaXX-AS-C**



**AutoMaXX-AS-B**

## Aprovimi CBRN

Skuadrat e Përgjigjes së Parë të sotme ballafaqohen me një llojllojshmëri të rreziqeve potenciale. Mundësia për tu thirrur për të reaguar gjatë një sulmi terrorist me armë kimike ose biologjike është vetëm duke u rritur, pasi nuk ka standarde jashtë SHBA-së, standardi Britanik BS 8468-1, është formuar. Pajisja e frymëmarrjes "CRBN" e MSA-së përshtatet me atë standard dhe gjithashtu me EN 137. Shumica e konfigurimeve të AirMaXX mund të kthehen në një pajisje "CBRN" duke përdorur valvuolën thithëse AutoMaXX që përmbanë një diafragmë të veçantë me gomë butili.

# Maska

## Ultra Elite

Maska e fytyrës Ultra Elite është ndërtuar duke menduar për të ardhmen. Dizjani i sajë ergonomik, teknologjia më moderne dhe vëmendja për detaje e bëjnë zgjedhjen ideale për punëtorë që kanë nevojë të shpeshë të mbrojtjes së frymëmarrjes për detyra që kërkojnë vëmendje.
Ultra Elite ergonomike dallohet me fushën e shikimit të pa penguar, rehati të pakrahasuar gjatë veshjes dhe transmetim të përkryer të të folurit.
Ultra Elite gjindet me mbi 40 versione të ndryshme dhe me shumë lloje të aksesorëve që të ju përshtaten çdo nevoje.
Për aplikime që sgjasin shumë kohë versionet me maskë, mbulojë të hundës dhe rripa prej silikonit të verdhë janë optimale. Silikoni është tolerant ndaj lëkurës dhe resistant kundër ozonit dhe rrezatimit UV. Për më shumë informata ju lutem shikoni broshurën tonë ID 05-418.2.


Ultra Elite-PS-MaXX me AutoMaXX-AS


Ultra Elite-H-PS-MaXX me AutoMaXX-AS

## 3S

Me mbi 5 milion njësi të shitura, 3S është dizajni më i sukseshëm i maskave për fytyrë në botë. Me rehati dhe siguri të vërtetuar, 3S është maska klasike ku profesionalistët janë mësuar që të përdorin.
3S gjindet me mbi 50 versione për virtualisht të gjitha aplikimet. Maska 3S ofrohet gjithashtu me silikon të verdhë, i cili nuk e irriton lëkurën dhe është rezistent gjatë viteve. Disa versione të 3S të MSA ofrohen edhe në madhësi të vogël. Për më shumë informata ju lutem kërkoni broshurën tonë ID 05-405.2.


3S-PS-MaXX me AutoMaXX-AS

# Kombinimet Maskë-Helmetë


Ultra Elite-H-PF-F1
(me helmetën MSA GALLET)


3S-H-PS-MaXX F1
(me helmetën MSA GALLET)

Të dyja, Ultra Elite dhe 3S ofrohen si kombinim maskë-helmetë. Rripa të veçantë të përshtatshëm prej gome e sigurojnë maskën drejtë në helmetë, shpejtë dhe sigurtë, dhe eleminojnë nevojën për ta hequr helmetën.
Maska mund të hiqet shumë lehtë prej helmetës kur mbrojtja e frymëmarrjes nuk nevoitet më. Për më shumë informacione ju lutem kërkoni broshurën ID 05-432.2.

# Aksesorët

## Cilindrat

MSA i ofron cilindra të ajrit të kompresuar edhe prej çelikut edhe prej materialit kompozit siq të ju nevoitet. Cilindrat prej çelikut gjinden edhe në versionet 4 litra/ 200 bar ose 6 litra/ 300 bar.
Cilindrat kompozit janë 50% më të lehtë se sa versioni tradicional prej çeliku. Këto ofrohen në madhësitë prej 6, 6.8, 6.9, ose 9 litra me shtypje të hapjes 300 bar dhe me mundësi të jetëgjatësisë prej 30 vitesh. Opsionet e valvuolës përfshijnë një manometër të integruar, dorezë rrotulluese për të parandaluar mbylljen e padëshiruar, dhe ndaluesën e rrjedhës në rastin që prishet valvuola. Ju lutem kërkoni broshurën e veçantë.



## Kutia mbajtëse

Kutia mbajtëse e lehtë dhe e qëndrueshme e mban sistemin tuaj SCBA, deri në dy cilindra, një valvuolë thithëse dhe një maskë. është ideale për të transportuar pajisjet për servisim ose për udhëtim.



### Veçoritë

- Rrota të përshtatshme për transport
- Akomodon çdo set BA me deri në dy cilindra
- Ndarjet e veçanta ofrojnë ruajtje pa përplasje
- Rrota për manovrim të mirë
- Shumë e qëndrueshme

## Çantë për Skuadrën e Intervenimit të Shpejtë

Çanta për Skuadrën e Intervenimit të Shpejtë mbahet nga një zjarrfikës dhe ofron ajër të pastër për një person që ka pësuar një aksident në një atmosferë të rrezikshme.
Është e furnizuar me një sistem pneumatik i cili është i lidhur me një cilindër ekzistues. Varësisht prej aplikimit mund të bashkohet me kapelën shpëtuese RespiHood ose me një kombinim të valvuolës thithëse dhe maskës së fytyrës, siq të nevoitet. Ju lutem kërkoni për broshurën individuale.




## RespiHood

RespiHood është e dizajnuar për të shpëtuar njerëz prej zonave të rrezikshme. Vendoset mbi kokë dhe pastaj shiriti i qafës shtrëngohet. Ajri ofrohet nga lidhja dytësore e SCBA. RespiHood mund të paloset dhe të ruhet në një çantë rezistente ndaj ujit për mbajtje të lehtë.



Vizori i madh me shtresë kundër mjegullimit i RespiHood ofron njëfushë shikimi të gjerë dhe kështu parandalon panikimin.

# Konfigurimi individual dhe servisimi

## Konfigurimi i SCBA

Kostumizimi i SCBA-së tuaj është shumë i lehtë duke përdorur Konfiguruesin tonë interaktiv. Konfiguruesi ju lejon që të krahasoni dhe të zgjedhni opsione për komponentët e SCBA-së sipas nevojës tuaj. Pas çdo konfigurimi shfaqet një vizualizim 3D. Kur të përfundoni, ju mund të kërkoni një vlerësim për konfigurimin tuaj.

Konfiguruesi mund të gjindet online në: msa-scba.com




## Servisimi

Së bashku me Sistemet SCBA të teknologjisë së lartë, MSA gjithashtu ofron një nivel të lartë të mbështetjes për kostumizim dhe për servisim. MSA ofron çdo lloj këshille dhe ndihme që mund të ju nevoitet për të vendosur mbi kërkesat ekzakte, kështu duke siguruar që konfigurimi i SCBA që zgjedhni do të ofrojë performancën më të lartë për çmimin më të ulët. Të gjithë komponentët e SCBA janë të lehtë për tu mirëmbajtur. Nëse dëshironi që të përdorni shërbimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes së MSA, të cilat përfshijnë zëvendësimin e pajisjeve gjatë riparimit, thjeshtë kontaktoni distributorin tuaj lokal të MSA për më shumë detaje.

MSA Service

## Informata rreth porosisë

Ju lutemi kërkoni për një fletë të veçantë për porosi.

**www.msa-scba.com**

# MSA in Europe

*www.msa-europe.com & www.msa-gasdetection.com*

## Northern Europe

**Netherlands**
**MSA Nederland**
Kernweg 20, 1627 LH Hoorn
Phone +31 (229) 25 03 03
Telefax +31 (229) 21 13 40
E-Mail info@msaned.nl

**Belgium**
**MSA Belgium**
Duwijckstraat 17, 2500 Lier
Phone +32 (3) 491 91 50
Telefax +32 (3) 491 91 51
E-Mail msabelgium@msa.be

**Great Britain**
**MSA Britain**
Lochard House
Linnet Way
Strathclyde Business Park
BELLSHILL ML4 3RA
Scotland
Phone +44 (16 98) 57 33 57
Telefax +44 (16 98) 74 01 41
E-Mail info@msabritain.co.uk

**Sweden**
**MSA NORDIC**
Kopparbergsgatan 29
214 44 Malmö
Phone +46 (40) 699 07 70
Telefax +46 (40) 699 07 77
E-Mail info@msanordic.se

**MSA SORDIN**
Rörläggarvägen 8
33153 Värnamo
Phone +46 (370) 69 35 50
Telefax +46 (370) 69 35 55
E-Mail info@sordin.se

## Southern Europe

**France**
**MSA GALLET**
Zone Industrielle Sud
01400 Châtillon sur Chalaronne
Phone +33 (474) 55 01 55
Telefax +33 (474) 55 47 99
E-Mail message@msa-gallet.fr

**Italy**
**MSA Italiana**
Via Po 13/17
20089 Rozzano (MI)
Phone +39 (02) 89 217 1
Telefax +39 (02) 82 59 228
E-Mail info-italy@msa-europe.com

**Spain**
**MSA Española**
Narcís Monturiol, 7
Pol. Ind. del Sudoeste
08960 Sant-Just Desvern
(Barcelona)
Phone +34 (93) 372 51 62
Telefax +34 (93) 372 66 57
E-Mail info@msa.es

## Eastern Europe

**Poland**
**MSA Safety Poland**
ul. Wschodnia 5A
05-090 Raszyn k/Warszawy
Phone +48 (22) 711 50 33
Telefax +48 (22) 711 50 19
E-Mail eer@msa-europe.com

**Czech Republic**
**MSA Safety Czech**
Pikartská 1337/7
716 07 Ostrava-Radvanice
Phone +420 (59) 6 23 22 22
Telefax +420 (59) 6 23 26 75
E-Mail info@msa-auer.cz

**Hungary**
**MSA Safety Hungaria**
Francia út 10
1143 Budapest
Phone +36 (1) 251 34 88
Telefax +36 (1) 251 46 51
E-Mail info@msa.hu

**Romania**
**MSA Safety Romania**
Str. Virgil Madgearu, Nr. 5
Ap. 2, Sector 1
014135 Bucuresti
Phone +40 (21) 232 62 45
Telefax +40 (21) 232 87 23
E-Mail office@msanet.ro

**Russia**
**MSA Russia**
Leninsky Prospekt 2
9th Floor, office 14
119049 Moscow
Phone +7 (495) 544 93 89
Telefax +7 (495) 544 93 90
E-Mail msa-moscow@
msa-europe.com

## Central Europe

**Germany**
**MSA AUER**
Thiemannstrasse 1
12059 Berlin
Phone +49 (30) 68 86 0
Telefax +49 (30) 68 86 15 17
E-Mail info@auer.de

**Austria**
**MSA AUER Austria**
Kaplanstrasse 8
3430 Tulln
Phone +43 (22 72) 63 360
Telefax +43 (22 72) 63 360 20
E-Mail info@msa-auer.at

**Switzerland**
**MSA Schweiz**
Eichweg 6
8154 Oberglatt
Phone +41 (43) 255 89 00
Telefax +41 (43) 255 99 90
E-Mail info@msa.ch

## European International Sales

(Africa, Asia, Australia,
Latin America, Middle East)
**MSA EUROPE**
Thiemannstrasse 1
12059 Berlin
Phone +49 (30) 68 86 55 5
Telefax +49 (30) 68 86 15 17
E-Mail contact@msa-europe.com

**Your direct contact:**

Adresa: Kompleksi Industrial TEKNIKU
Fsh.Lug Bunar, 50000 Gjakove
NRB: 70119037
NRF: 600094932
Tel. 0390 326 497
Mob. 044 122 927, 044 129 214
e-mail: info@tekniku.net; tekniku@yahoo.com
htpp: www.tekniku.net

Subject to change without notice.
ID 01-103.2 GB/01/N/05.10/HH

MSA
*The Safety Company*